

NJOFTIM PËR HAPJEN E KONKURRIMIT PUBLIK

Mbështetur në paragrafin 2 të nenit 4 të Rregullores “Për përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur”, të miratuar me Vendimin nr. 66, datë 07.11.2016 të Këshillit Drejtues të RTSH, Njësia e Programeve në RTSH shpall publikisht hapjen e konkurrimit publik për mbledhjen e projekteve nga subjektet e interesuara:

Objekti:	Financim i prodhimit të programeve të pavarura të transmetimit audioviziv
Forma e prodhimit:	Prodhim i porositur
Lloji i prodhimit audioviziv:	Prodhim filmik
Numri i dokumentarëve:	Dokumentarë
Kohëzgjatja e një dokumentari:	10 (dhjetë)
Fondi financiar:	35 (tridhjetëpesë) minuta deri në 40 (dyzetë) minuta
Natyra e dokumentarëve:	5,000,000.00 (pesëmilionë) lekë
Grup-mosha:	Dedikuar artit dhe krijimtarisë të artistëve shqiptarë pas vitit 1990. Në fokus arti kontemporan në Shqipëri.
Vendi i prodhimit:	Për të gjitha moshat.
Gjuha:	Republika e Shqipërisë
Afatet e prodhimit:	Gjuha shqipe.
Periudha e transmetimit:	90 (nëntëdhjetë) ditë, nga data e nënshkrimit të kontratës me RTSH
Formati i prodhimit:	Transmetimi i parë i dokumentarit të parë: muaji Mars 2022
Audio:	16:9, Full HD, 4K, (sony-f55-cinelata-4k)
Ngjyrat:	Stereo
Të drejtat:	Me ngjyra
Forma e të drejtave:	RTSH zotëron të gjitha të drejtat e shfrytëzimit pasuror të secilit prej 10 (dhjetë) dokumentarëve.
Kohëzgjatja e të drejtave:	Ekskluzive
Territori:	E pakufizuar
Numri i transmetimeve:	Republika e Shqipërisë si dhe të territoret e të gjithë shteteve të Botës I pakufizuar

Personi fizik ose juridik i interesuar duhet të paraqesë kërkesën pranë Sektorit të Projekteve dhe të Administrimit të të Drejtave në RTSH brenda datës 05 Maj 2021, deri në orën 12:00, e cila duhet të përmbajë detyrimisht dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Përshkrimi narrativ i projektit, qëllimi dhe objektivat e projektit, anët pozitive dhe anët negative të projektit, projekt – preventivi financiar i buxhetit të projektit i detajuar në zëra të veçantë;
2. Skenari/Sinopsi i projektit;
3. Stafi i parashikuar për realizimin e projektit;
4. Ekstrakti i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit ose Ekstrakti Historik i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;
5. Çertifikata e regjistrimit e personit të tatueshëm për personin fizik të interesuar ose për personin juridik të interesuar, të mos jetë më e vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;
6. Dokument i lëshuar nga Administrata Tatimore e Shqipërisë, përmes të cilës vërtetohet se personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Dokumenti të mos jetë më i vjetër se 10

- (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;
7. Dokument i lëshuar nga Administrata Tatimore e Shqipërisë, përmes të cilës vërtetohet se personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Dokumenti të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;
 8. Leja e Produksionit e personit fizik të interesuar ose e personit juridik të interesuar, e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë së Shqipërisë, e cila duhet të jetë e vlefshme;
 9. Vërtetim i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, përmes të cilës vërtetohet se për personin fizik të interesuar ose për personin juridik të interesuar, sipas regjistrave të gjykatës nuk rrezulton që të ketë proces gjyqësor civil me RTSH;
 10. Vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, që personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka procedim penal të regjistruar në ngarkim të tij;
 11. Deklaratë noteriale përmes të cilës personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar merr përsipër të gjitha detyrimet në lidhje me të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të për përdorimin e veprave në projekt;
 12. CV e personit fizik të interesuar ose e personit juridik të interesuar;
 13. Vendi i realizimit të projektit;
 14. Deklaratë e personit fizik ose juridik që:
 - (i) personat pjesëmarrës në program, apo të përfshirë në në përgatitjen e tij dhe pajisjet e mjetet për realizimin e programit vendosen nga vetë personi fizik ose juridik;
 - (ii) nuk është një transmetues audioviziv, pjesë e tij, apo aksionar në një transmetues;

Personi fizik ose juridik i interesuar, përveç dokumentacionit të kërkuar si më sipër, duhet të plotësojë formularin që përmban informacionin e domosdoshëm mbi projektin dhe subjektin aplikues.

Formulari mund të tërhiqet pranë Sektorit të Projekteve dhe të Administrimit të të Drejtave në RTSH çdo ditë, nga ora 10:00 deri në orën 15:00.